



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:037809

Datë: 11.06.2024

Numri i dokumentit: 05809838

PAKR.nr.41/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për të Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Xhevdet Abazi, kryetar i kolegjit, Hashim Çollaku dhe Zyhdi Haziri, anëtar, me bashkëpunëtoren profesionale Albulena Rexha, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit R.I., nga Mitrovica, për shkak të veprës penale falsifikimi i rezultateve të votimit, nga neni 219 par.2 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Departamenti për Krime të Rënda, P.nr.89/2023, të dt.29.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt.06.06.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Departamenti për Krime të Rënda, P.nr.89/2023, të dt.29.12.2023, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Departamenti për Krime të Rënda, P.nr.89/2023, të dt.29.12.2023, i akuzuari R.I., për shkak të veprës penale falsifikimi i rezultateve, të votimit, nga neni 219 par.2 të KPK, është liruar nga akuza, në kuptim të nenit 363 par 1 pika 1.3 të KPPK, sepse nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Shpenzimet e procedurës penale kanë ra në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Kundër këtij aktgjykimi ankesë ka ushtruar Prokuroria Themelore në Mitrovicë, për shkak të shkeljeve të ligjit penal, si dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke propozuar që aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Departamenti për Krime të Rënda, P.nr.89/2023, i dt.29.12.2023, të anulohet dhe çështja penale ti kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim e vendosje.

Përgjigje në ankesë të prokurorisë ka ushtruar mbrojtësi i të akuzuarit R.I., av.Diar Jusufi, dhe ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Departamenti për Krime të Rënda, P.nr.89/2023, të dt.29.12.2023, të refuzohet si e pa bazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë, me shkresën PPA/I.nr.56/2024, të datës 31.01.2024, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e ushtruar nga ana e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, ka propozuar që e njëjta të aprovohet si e bazuar dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Departamenti për Krime të Rënda, P.nr.89/2023, të dt.29.12.2023, të anulohet kurse çështja penale ti kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim e vendosje.

Sa i përket përgjigjes në ankesë, ka vendosur që e njëjta të refuzohet si e pabazuar.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, në kuptim të nenit 390 të KPPK, ka caktuar seancën e kolegjit për datën 06.06.2024. dhe në mënyrë të rregullt i ka njoftuar të gjitha palët nga shkresat e lëndës.

Në seancë të kolegjit kanë prezantuar i akuzuari R.I., ndërsa nuk kanë prezantuar Prokurori i Apelit, si dhe av.Diar Jusufi, përkundër asaj që i kanë pranuar njoftimet me rregull.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenin 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e ushtruar, nga ana e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, aktgjykimit të ankimuar, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

Ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, nuk është e bazuar.

Meqenëse aktgjykimi i gjykatës së shkalës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, kolegji i kësaj gjykate e ka shqyrtuar aktgjykimin si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, të parapara në kuptim të nenit 384 të KPPK, për të cilat shkelje kolegji i Gjykatës së Apelit, përkujdeset sipas detyrës zyrtare në pajtim të nenit 394 të KPPK, dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij, për të cilat kjo gjykatë kujdeset kryesisht sipas detyrës zyrtare.

Sipas ankesës së prokurorisë, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar për shkak të shkeljeve të ligjit penal, duke pretenduar se në këtë çështje penale gjykata e shkallës së parë edhe pse ka pasur prova të mjaftueshëm për të vërtetuar elementet inkriminuese të akuzuarit R.I., që në veprimet e të njëjtit janë formuluar elementet qenësore të veprës penale falsifikimi i rezultateve të votimit, nga neni 219 par.2 të KPK, të cilat veprime justifikohen nga të gjitha provat materiale, nga shkresat e lëndës, sikurse është libri i votimit, në vendvotimin 1111b/03R, formulari i përputhjes së të dhënave dhe rezultateve të krijuara në vendvotimin 1111b/03R dhe i numëruar në QNR, tabela exel, e specifikuar me emrin e kandidatit, subjektit politik dhe pasqyra e votave të numëruara në vendvotim dhe rezultateve pas rinumërimit në QNR, kanë qenë prova të mjaftueshme të cilat e vërtetojnë se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, e jo çfarë vendimi ka nxjerrë gjykata e shkallës së parë, kinse në mungesë të provave të akuzuarin e ka liruar nga akuza, në kuptim të nenit 363 par.1 nën par.1.3 të KPPK.

Kolegji i kësaj gjykate e ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, përkitazi me ankesën e prokurorisë, lidhur me shkeljet e ligjit penal, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim që në këtë çështje penale, aktgjykimi nuk përfshihet me shkelje të ligjit penal, sepse gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të qartë ka vlerësuar të gjitha provat të cilat janë

proceduar dhe ndërlidhur me këtë çështje penale dhe pas vlerësimit të të njëjtave ka ardhur në përfundim se i akuzuari R.I., nuk është provuar se ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, ashtu që në mënyrë të drejtë dhe gjithëpërfshirëse, ka vlerësuar dispozitën ligjore, përkritazi me shkeljet e ligjit penal, në kuptim të nenit 385 të KPPK.

Kolegji ka vlerësuar se vepra penale për të cilën i akuzuari është akuzuar, është e përfshirë në dispozitën ligjore të KPK, se gjatë punës dhe gjatë vlerësimit të gjitha provave, sikurse atyre personale, po ashtu edhe atyre materiale, ka ardhur në përfundim se i akuzuari pasi që nuk e ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, është liruar nga akuza në kuptim të nenit 363 par.1 pika 1.3 të KPPK.

Po ashtu kolegji ka vlerësuar se në këtë çështje penale, pasi që nuk është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale, të njëjtin e ka përjashtuar nga përgjegjësia penale, si dhe nga ndjekja penale, se është aplikuar ligji i cili ka qenë i aplikueshëm në kohën e kryerjes së veprës penale, dhe se gjykata e shkallës së parë, ka vepruar në kuadër të kompetencës ligjore.

Sipas ankesës së prokurorisë, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është ankimuar për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke pretenduar se gjykata e shkallës së parë, me të gjitha provat të cilat i ka proceduar, pasi të njëjtat kanë rezultuar si mbështetje e aktakuzës së ngritur, dhe pas vlerësimit të të njëjtave, në mënyrë të pa dyshimtë, është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit, janë formuluar elementet qenësore të veprës penale falsifikimi i rezultateve të votimit, nga neni 219 par.2 të KPK. Kjo rezulton dhe pas rinumërimit në QNR, pasi që është bërë krahasimi i të dhënave të cilat janë krijuar në vendvotim nga KVV, dhe ato të numërimit në QNR, me çrast është identifikuar ndryshimi i votimeve, ku i akuzuari së bashku me anëtarët e tjerë të KVV, me rastin e numërimit të votave të kandidatëve, brenda një subjekti politik, kanë hequr votat e disa kandidatëve dhe i kanë shënuar të disa kandidatëve të tjerë, duke regjistruar në mënyrë jo të saktë, gjithsej 290 vota, prej tyre, 237 vota të shtuara dhe 53 të hequra, e që në këtë rast duke u bazuar në par.2 dhe 3 të nenit 102 të ligjit për mbajtjen e zgjedhjeve, ka pasur edhe shtatë anëtarë të tjerë, që e kanë formuar komisionin numër 11111b/03R, përgjegjës për këtë veprim të drejtpërdrejt në kuadër të këtij komisioni ka qenë i akuzuari R.I., si kryesues i vendvotimit. Që të gjitha veprimet e ndërmarra në këtë qendër të vendvotimit janë ndërlidhur në veprimet që i kanë ndërmarrë këtu i akuzuari R.I., i cili edhe ka deklaruar se përkundër asaj që kemi pasur trajnim tre ditor, ka mundur që të ketë edhe pa rregullsi. Në bazë të përgjegjësive të cilat i kam pasur, i kam ndarë punët, ashtu që secili anëtarë ka qenë i ngarkuar me përgjegjësitë e veta, kurse përgjegjësia e R.I.t, si kryesues ka qenë kryesore, andaj edhe i njëjti me të drejtë është akuzuar për veprën penale e cila i vihet në barrë.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me ankesën e ushtruar nga ana e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim se në këtë çështje penale aktgjykimi i marrë kundër të akuzuarit R.I., për shkak të veprës penale, falsifikimi i rezultateve të votimit, nga neni 219 par.2 të KPK, lidhur me lirimin nga akuza, në kuptim të nenit 363 par.1 nën par.1.3 të KPPK, pasi që nuk është provuar se i njëjti ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, është i drejt dhe i bazuar, pasi që nuk përfshihet me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Nga shkresat e lëndës rezulton se i akuzuari nuk e ka pranuar fajësinë lidhur me veprën penale e cila i vihet në barrë, duke theksuar

se në këtë çështje penale kompetencat dhe detyrat e mia i kam ushtruar në bazë të autorizimeve që i kam pasur, ashtu që nuk kam kryer kurrfarë falsifikimi në vendvotimin ku unë kam qenë kryesues.

Po ashtu deklaratat e të akuzuarit korrespondon edhe me provat materiale nga shkresat e lëndës, sikurse është libri i votimit, për vendvotimin nr.1111b/03R, formulari i përputhjes së të dhënave dhe rezultateve të krijuara në vendvotimin 1111b/03, e numëruar në QNR, tabela exel, e specifikuar me emrin e kandidatit, subjekti politik dhe pasqyra e votave të numëruara në vendvotimin dhe rezultati pas rinumërimi në QNR, të cilat janë hequr apo shtuar, FRP e rinumëruar në QNR, që rezultojnë se të njëjtat nuk janë kontestuese, mirëpo gjatë vlerësimit nga ana e gjykatës së shkallës së parë, duke u bazuar në faktet e lartë cekura, gjykata e shkallës së parë nuk ka mundur që të provoj fajësinë për të akuzuarin.

Nga aktakuza e ngritur kundër të akuzuarit R.I., rezulton se i njëjti në pozitën e kryesuesit, të këshillit të vendvotimit nr.1111b/03R, duke e përdorur pozitën e tij zyrtare, ose autorizimin zyrtar, lidhur me zgjedhjet gjykata e shkallës së parë nuk ka mundur që të vërtetoj se i akuzuari ka bërë ndërhyrje për të ardhur në përfundim që janë hequr votat e ndonjë kandidati apo ndonjë subjekti, respektivisht se i ka falsifikuar rezultatet sipas numërimit të pretenduar nga prokuroria për 290 vota. Në asnjë mënyrë nuk është manifestuar dashja për të falsifikuar votat e kandidatëve apo të subjektit politik, përkundër asaj që gjykata ka vërejtur se FPR si dhe FRK, në vendvotimin nr.1111b/03R, e kishte plotësuar kryesuesi i këtij vendvotimi, pra i akuzuari, mirëpo nuk ka mundur të nxjerr konstatimin se i akuzuari ka falsifikuar rezultatet, apo shtuar dhe hequr votat për disa kandidatë ose subjekte politike. Nga vlerësimi i të gjitha provave, sikurse atyre personale, po ashtu atyre materiale, rezulton se i akuzuari në mënyrë të qartë dhe në përputhje me rregulloret përkatësisht ligjin për zgjedhjet ka udhëhequr qendrën e vendvotimit, dhe në përputhje me autorizimet që ka pasur, ka rezultuar se i njëjti nuk ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, andaj gjykata e shkallës së parë pasi që nuk ka provuar se në veprimet e të akuzuarit janë formuluar elementet e veprës penale për të cilën është akuzuar, të akuzuarin e ka liruar nga akuza në kuptim të nenit 363 par.1 pika 1.3 të KPPK.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.41/2024, të datës 06.06.2024

Procesmbajtëse,
Albulena Rexha

Anëtarët e kolegjit,
Hashim Çollaku

Kryetari i kolegjit,
Xhevdet Abazi

Zyhdi Haziri